

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Njësi Org. Org. Unit	01	Nr. Prot. Sr. Prot. Prot. No:	543-1
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	4	Data Datum Date:	20/04/2021
PRISHTINE/A			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers

Nr. 20/2021

Datë: 20.04.2021

Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyres së Kryeministrit dhe Ministrive, dhe në mbështetje të Vendimit të Qeverisë së Republikës nr. 01/07, i datës 18.04.2021, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID -19, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, sot me datë 19.04.2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Shtyhet afati deri më 31 maj 2021, për dorëzimin e deklarimeve për pasivitet të vitit paraprak afarist për shoqëritë tregtare, të cilat gjatë vitit afarist nuk kanë pasur aktivitet afarist dhe nuk kanë regjistruar asnjë të dhënë mbi pasuritë dhe detyrimet në librat kontabël në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar.
2. Shtyhet afati deri më 31 maj 2021, për dorëzimin për publikim të pasqyrave vjetore financiare dhe raporti i auditimit të pasqyrave financiare vjetore financiare nga shoqëritë tregtare në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar.
3. Shtyhet afati deri më 31 maj 2021, për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore bashkë me raportin e rishikimit në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar.
4. Shtyhet afati deri më 31 maj 2021, për dorëzimin dhe publikimin e pasqyrave financiare të audituara në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar dhe ministrinë përkatëse për tregti dhe industri.
5. Shtyhet afati deri më 31 maj 2021, për dorëzimin e pasqyrave për pozitën financiare, llogaritë e fitimit dhe humbjeve si dhe informatat shtesë lidhur me vitin paraprak kalendarik për qëllime statistikore dhe qëllime të tjera në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës.
6. Të gjitha pasqyrat financiare për nevojat e përgjithshme të audituara dhe të rishikuara do të dorëzohen në formë elektronike dhe fizike në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar.

7. Pasqyrat financiare për mikro-ndërmarjet dhe deklaratat mbi pasivitetin do të dorëzohen në formë elektronike përmes sistemit elektronik jo më vonë se data 31 maj 2021, ndërsa pasqyrat financiare dhe/ose deklaratat të konsoliduara jo më vonë se data 30 qershor 2021.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Hekuran MURATI


Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

